

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 629 Prot.

Tiranë, më 10.052017

**VENDIM Nr. 68, datë 26.04.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), doktorant Adrian Anastasi dhe udhëheqës Prof. Muzafer Korkuti, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), doktorant Adrian Anastasi dhe udhëheqës Prof. Muzafer Korkuti, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Vazhdimi i kërkimeve nënujore në Kepin e Rodonit dhe të Lagjit
    - Të fillojë zonifikimi mbrojtës për Kepin e Rodonit.
    - Të fillojë puna për të ndërtuar planimetrinë e fortifikimit të Gjergj Kastriotit, i cili ndodhet në pjesën më të madhe nënujore.
    - Të vazhdojë dokumentimi grafik, fotografik dhe video i siteve prehistorike, në liqenet e Ohrit dhe të Prespës.
      - Të zgjerohen kërkimet në Prespën e vogël.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

